



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 33 pr
Dt. 28/06/2022

VENDIM

Nr. 26, datë 22.06.2022

PËR

**MIRATIMIN E E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIM
BURIMI UJOR PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE,
TË BASHKISË SHKODËR, ME VENDNDODHJE LIQENI I
SHKODRËS, BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Shkodër, "Për përdorimin e burimit ujor për veprimtari ndërtimore në brigje", të Bashkisë Shkodër, me vendndodhje liqeni i Shkodrës, bashkia Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i trupit ujor: Liqeni i Shkodrës, Lumi Buna

Koordinatat e vendodhjes së trupit ujorë (KRGJSH)

-X ₁ =457583	Y ₁ =4657869	Z ₁ =10 m.m.n.d
-X ₂ =455103	Y ₂ =4658431	Z ₂ =10 m.m.n.d
-X ₃ =450412	Y ₃ =4659759	Z ₃ =10 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

